

<b>Tel: +355 4 22 69097</b> <b>+355 4 22 69325</b> <b>Fax:</b> <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b>	<b>Udhëzues për kalimin nga</b> <b>ISO / IEC 27006: 2015 në</b> <b>ISO/IEC 27006:2015 AMD1:2020</b>	<b>Kodi DA-IN-014</b>
		<b>Rishikim nr 0</b> <b>Dt 08.09.2020</b>
		<b>Faqe 1- 4</b>

**Udhëzues për kalimin nga ISO / IEC 27006: 2015 në ISO/IEC 27006:2015 AMD1:2020**

**Zbatuesit: Stafi i DPA-së, vlerësuesit teknik dhe organet certifikues të sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit**

**Përgjegjësi për zbatim: Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit**

**Kontrolloi: Suela Kromidha**

**Miratoi: Armond HALEBI**

<p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Udhëzues për kalimin nga</b>  <b>ISO / IEC 27006: 2015 në</b>  <b>ISO/IEC 27006:2015 AMD1:2020</b></p>	<p><b>Kodi DA-IN-014</b></p> <hr/> <p><b>Rishikim nr 0</b>  <b>Dt 08.09.2020</b></p> <hr/> <p><b>Faqe 2- 4</b></p>
---	--	--

## **1.QËLLIMI**

Ky dokument përshkruan udhëzime për kalimin nga Standardi ISO / IEC 27006: 2015 në ISO/IEC 27006:2015 AMD1:2020. Ky dokument është i vlefshëm për DPA dhe vlerësuesit e saj si dhe për organet certifikuese të sigurisë së informacionit të akredituar nga DPA, që kanë aplikuar për akreditim apo që kanë për qëllim të aplikojnë për akreditim.

## **2. FUSHA E ZBATIMIT**

Ky udhëzues zbatohet nga vlerësuesit dhe stafi i DPA, nga nënkontraktuesit e saj për vlerësimin e trupave certifikues që kryejnë certifikim të sistemeve të sigurisë së informacionit në përputhje me këtë standard.

## **3. PËRGJEGJËSITË**

Ky udhëzues është pjesë e sistemit të menaxhimit të DPA dhe si e tille është nën përgjegjësinë e menaxherit të cilësisë të DPA rishikimi i vazhdueshëm në varësi të ndryshimeve të duhura dhe përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin e menaxhimit të DPA. Është detyrë e Drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit të kontrollojë zbatimin e këtij udhëzimi.

## **4. REFERENCA**

Rezoluta IAF aprovuar më datë 27 korrik 2020 për Marrëveshjen kalimtare për ISO / IEC 27006: 2015 AMD 1: 2020.

## **5. FJALORI DHE SHKURTIME**

Në këtë udhëzues është përdorur terminologjia e standardit ISO/IEC 17011:2017

IAF      Forum Nderkombëtar i Akreditimit  
DPA      Drejtoria e Përgjithëshme e Akreditimit

<p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Udhëzues për kalimin nga</b>  <b>ISO / IEC 27006: 2015 në</b>  <b>ISO/IEC 27006:2015 AMD1:2020</b></p>	<p><b>Kodi DA-IN-014</b></p> <hr/> <p><b>Rishikim nr 0</b>  <b>Dt 08.09.2020</b></p> <hr/> <p><b>Faqe 3-4</b></p>
---	--	---

## **6. PËRMBAJTJA**

### **1. Të përgjithshme**

Bazuar në Rezolutën IAF aprovuar më datë 27 korrik 2020 për Marrëveshjen kalimtare për ISO / IEC 27006: 2015 AMD 1: 2020, trupat certifikuese të sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS) të akredituara duhet të plotësojnë kërkesat e standardit ISO / IEC 27006: 2015 AMD 1: 2020, brenda 2 vjetësh duke filluar nga dita e fundit e muajit të publikimit të këtij standardi.

a) Deri më datë 31 Mars 2022, të gjithë trupat certifikues të sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit të akredituar duhet të kenë përfunduar kalimin e suksesshëm tek ISO / IEC 27006: 2015 AMD1: 2020.

b) Të gjitha dokumentat e akreditimit në lidhje me certifikimin e ISMS kundrejt ISO / IEC 27006: 2015 shfuqizohen pas datës 31 Mars 2022.

DPA do të integrojë në skemën e akreditimit të gjitha kërkesat e standardit ISO / IEC 27006: 2015 AMD 1: 2020 dhe rregullat e IAF. Dpa do të jetë e gatshme brenda datës 30 Nentor 2020 të kryejë vlerësime të tranzicionit për ISO / IEC 27006: 2015 AMD 1: 2020.

Trupat certifikuese të ISMS të akredituara nga DPA duhet të demonstrojnë përputhshmërinë e aktiviteteve të certifikimit me standardin ISO/IEC 27006:2015 AMD 1:2020 gjatë vizitave mbikëqyrëse të rradhës nëq ato janë parashikuar për tu realizuar brenda datës 31 Mars 2022.

Data e zhvlerësimit të certifikimeve të standardit ISO / IEC 27006: 2015 lëshuar gjatë periudhës së tranzicionit duhet të korrespondojë me përfundimin e periudhës dy vjeçare të tranzicionit.

### **2. Tranzicioni për ISO / IEC 27006: 2015 AMD 1:2020**

Për të realizuar një transferim të lehtë drejt standardit të ri ISO / IEC 27006: 2015 AMD 1:2020, DPA ka vendosur një program të tillë:

DPA do të fillojë të informojë të gjithë trupat certifikuese të akredituara në lidhje me periudhën e tranzicionit për standardin e ri ISO / IEC 27006: 2015 AMD 1:2020 në zbatim të “Rezolutës IAF aprovuar më datë 27 korrik 2020 për Marrëveshjen kalimtare për ISO / IEC 27006: 2015 AMD 1: 2020”.

<p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Udhëzues për kalimin nga</b>  <b>ISO / IEC 27006: 2015 në</b>  <b>ISO/IEC 27006:2015 AMD1:2020</b></p>	<p><b>Kodi DA-IN-014</b></p> <hr/> <p><b>Rishikim nr 0</b>  <b>Dt 08.09.2020</b></p> <hr/> <p><b>Faqe 4-4</b></p>
---	--	---

DPA ka informuar të gjithë trupat certifikuese të akredituara në lidhje me daljen e standardit ISO/IEC 27006:2015 si dhe me udhëzuesin e DPA për kalimin tek ISO/IEC 27006:2015 AMD 1: 2020.

– Aplikimet e reja kundrejt standardit ISO /IEC 27006:2015 AMD 1: 2020 do të pranohen nga DPA që nga 1 Dhjetor 2020.

– Trupat certifikuese të akredituara nga DPA mund të kërkojnë vlerësime të përputhshmërisë brenda fushës së akreditimit në vizita mbikëqyrëse shtesë të kërkuara në DPA ndërmjet datës 01 Dhjetor 2020 deri më datë 30 Nentor 2021.

– Për aplikimet e reja kundrejt standardit ISO/IEC 27006:2015 ku vizita vlerësuese nuk është kryer deri më datë 1 Dhjetor 2020, atëherë vizita vlerësuese do të kryhet sipas standardit të ri ISO/IEC 27006:2015 AMD 1: 2020.

Për trupat certifikuese të akredituar nga DPA që demonstronë kompetencën dhe përputhshmërinë me kërkesat e standardit ISO/IEC 27006:2015 AMD 1: 2020 përpara datës 31 Mars 2022, certifikata e akreditimit është e vlefshme për të dyja standardet deri në datën 31 Mars 2022. Gjatë periudhës nga marrja e akreditimit deri në datën 31 Mars 2022 në websitin e DPA do të shfaqen të dyja certifikatat. Në datën 1 Prill 2022, DPA do të largojë nga website i saj të gjitha certifikatat e akreditimit sipas standardit ISO/IEC 27006:2015.

DPA do të organizojë vizitat mbikëqyrëse të rradhës në trupat certifikuese të sistemeve të menaxhimit të akredituar nga DPA që nuk janë vlerësuar kundrejt ISO/IEC 27006:2015 AMD 1:2020 përpara datës 30 Nentor 2021.

Për trupat certifikuese të akredituara nga DPA që dështojnë në plotësimin e kërkesave ISO/IEC 27006:2015 AMD 1:2020, DPA do të shfuqizojë apo reduktojë fushën e akreditimit kundrejt këtij standardi.

Të gjithë trupat certifikuese të sistemeve të menaxhimit të ISMS që janë tashmë të akredituar apo që vizita vlerësuese e parë është parashikuar të kryhet në përputhje me standardin ISO/IEC 27006:2015 AMD 1:2020 duhet të hartojnë një plan pune i cili duhet të përfshijë të paktën:

- Të gjitha veprimet që do të merren për të zbatuar ndryshimet e standardit, marrëveshjen e tranzicionit me klientët e tyre,
- Kohën që do të duhet për të zbatuar këto veprime,
- Personat përgjegjës për çdo veprim që do të ndërmerret,
- Treguesit monitorues të cilët do të tregojnë progresin dhe përfundimin e veprimeve.

<p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Udhëzues për kalimin nga</b>  <b>ISO / IEC 27006: 2015 në</b>  <b>ISO/IEC 27006:2015 AMD1:2020</b></p>	<p><b>Kodi DA-IN-014</b></p> <hr/> <p><b>Rishikim nr 0</b>  <b>Dt 08.09.2020</b></p> <hr/> <p><b>Faqe 5-4</b></p>
---	--	---

Plani i veprimit do të demonstrojë një analizë të kërkesave të standardit dhe zbatimin efektiv të tij nga trupa certifikuese brenda datës 31 Dhjetor 2020.

Është përgjegjësi e trupave certifikuese për tu familjarizuar me standardin e ri dhe të zbatojë ndryshimet e nevojshme për të plotësuar kërkesat e këtij standardi.

Planet e punës do të shqyrtohen nga DPA. Në rast se ato janë në kundërshtim me këtë udhëzues, DPA do të kërkoj ndryshime në planin e punës.

Vlerësimi do të përfshijë edhe rishikimin e marrëveshjes së tranzicionit të trupës së certifikimit për klientët e saj të certifikuar.